

George Carey dhe doktrina e trinitetit

## Description

# Anthony F. Buzzard dhe Charles F. Hunting

Fragment i shkëputur nga libri 'The doctrine of Trinity', me autor Anthony F. Buzzard dhe Charles F. Hunting, International Scholars Publication, Oxford 1998.

George Carey, i cili më pas u bë kryepeshkopi i Kanterbury-t, u ngrit në mbrojtje të doktrinës tradicionale të mishërimit në librin e tij, *God Incarnate: Meeting the Contemporary Challenges to a Classic Christian Doctrine*. Fuqia argumentuese e esesë së tij, qëndron në protestën e tij mëse të justifikuar kundër një tendence të shfaqur nga disa autorë të librit *Myth of God Incarnate* që përpiqeshin ta ripërkufizonin figurën e Jezusit në atë mënyrë që ajo të ishte sa më në përputhje me konceptimin e njeriut modern shkencor. Carey në mënyrë të ligjshme ndjehet i trazuar nga mohimi i konceptimit virgjëror të Jezusit, pamëkatshmërisë së tij si edhe ringjalljes së tij si një fakt objektiv i historisë. Në këtë mënyrë autorët e *Myth of God Incarnate*, minojnë së brendshmi forcën e tyre argumentative kundër këndvështrimit ortodoks të mishërimit. Ambivalenca e tyre fatkeqe lidhur me të mbinatyreshmen, veçanërisht ndaj ringjalljes, i pakëson vlerën argumentimit të tyre mëse të saktë kundër Trinitarianizmit. "Liberalët" shpesh i kanë shpallur luftë konservatorëve. Sidoqoftë, një "liberal" është më objektiv në shqyrtimin e tij të biblës, meqenëse ai është më pak i prirur sesa një konservator për të mbrojtur sistemin tradicional.

Duhet besuar fuqimisht në atë që Carey e quan: "lidhja e posaçme dhe e veçantë e Jezusit me Perëndinë" pa qenë nevoja, gjithsesi, që të pajtohemi me besimin se ai ishte vetë Perëndi<sup>1</sup>. Madje edhe vetë Carey ngurron ta quajë atë hapurazi Perëndi. Ai preferon të japë një përshkrim më pak të drejtpërdrejt për Jezusin: "ai është një farë mënyrë në formën e Perëndisë"<sup>2</sup>. Kjo i hap rrugën kuptimit të Jezusit si një e mesme midis këndvështrimit të disa autorëve të librit *The Myth of God Incarnate* dhe përfaqësuesve zyrtarë të trinitarianizmit. Nëse kristologjia e re duhet të pohojë elementin e mbinatyreshëm të portretit biblikë të Jezusit, e nëse Carey mund të rishikojë dobësinë e argumentimit të mishërimit me anë të terminologjisë "dërgoj" të përdorur në bibël, atëherë një kristologji më e bazuar në shkrimin do të marrë jetë. Jezusi, padyshim duhet deklaruar, duke ndjekur shembullin apostolik, si e vetmja mënyrë e shpëtimit. Por mundësia e të krishterëve që të : mbushen me plotësinë e Perëndisë (Efesianëve 3:19) duhet të balancojë theksimin që i ka bërë ortodoksia "plotësisë së Hyjnisë" (Kolosianëve 1:19; 2:19) në Jezusin si dëshmi se ai ishte Perëndi.

Mbrojtja që Carey i ka bërë doktrinës së trinitetit është e cenueshme në shumë pika. Ku gjendet mbështetja biblike për pohimin e kredos se Jezusi ka "lindur përpara gjithë kohërave", të cilën Carey duket se e beson pa e mbështetur atë në Dhjatën e Re? Përse qenka kaq e qartë se "dërgimi i Birit" nga ana e Perëndisë nënkupton që Biri ishte i gjallë përpara lindjes së tij? Pjetri nuk mendonte në asnjë lloj paraekzistence kur pohonte se Perëndia: "pasi e ngriti Jezusin, e dërgoi atë që ti predikonte Izraelit" (Veprat 3:26). Jezusi kishte marrë mandatin të predikonte, e jo dërguar, nga një tjetër jetë. Duket se autoritetet standarde leksikore e miratojnë dobësinë e përdorimit të fjalës "dërgoj" si argument për doktrinën zyrtare, ndërsa trysnia për ta ruajtur status quo-n e kësaj fjale në kristologji

mund të bëjë që parashtresit e saj ta anashkalojnë këtë fakt.

**Date Created**

02/10/2014

**Author**

erasmusi